



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 83, datë 19.06.2017

PËR

MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014 dhe të nenit 42, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në zbatim të programit të inspektimit nr. 435 Prot., datë 10.02.2017, ka ushtruar inspektim tematik në vend në Byronë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) dhe shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës (Insig sh.a., Albsig sh.a., Atlantik sh.a., Ansig sh.a., Eurosig sh.a., Intersig V.I.G sh.a., Sigma Interlbanian V.I.G sh.a., dhe Sigal Uniqa Group Austria sh.a.).

Inspektimi u krye në periudhën 15.02.2017-30.04.2017.

Nga verifikimet e kryera në vend u evidentuan problematikat përkatëse, të cilat i’u komunikuan drejtimit të BSHS-së edhe në takimin përmbyllës të inspektimit në datën 28.04.2017. Në përfundim të inspektimit, me shkresën nr. 1435, datë 15.05.2017, Byrosë Shqiptare të Sigurimit i’u dorëzuan gjetjet e konstatuara, të cilat u prezantuan edhe në takimin e datës 24.05.2017 në AMF me drejtuesin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe drejtuesit e shoqërive të sigurimit Jo-Jetë.

Pas shqyrtimit të observacioneve të dërguara nga BSHS me shkresën nr. 2970, datë 26.05.2017, grupi i inspektimit vlerëson se observacionet nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar situatës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, lidhur me performancën e saj dhe domosdoshmërinë për ndjekjen e problemeve që lidhen me funksionet e Byrosë,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit:
 - 1.1 Të hartojë rregulloren për funksionimin, përshkrimin dhe ndarjen e detyrave të strukturave të saj, brenda datës 31.08.2017;
 - 1.2 Të depozitojë në Autoritet brenda datës 31.07.2017, propozimet për ndryshimet e Rregullos nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”;
 - 1.3 Të përcaktojë në një rregullore të veçantë mënyrën e ndërtimit të evidencës së dëmit e cila minimalisht duhet të përmbajë numrin e dëmit, datën e ngjarjes (aksidentit), datën e raportimit të dëmit, përfituesin me emër e mbiemër, numrin personal sipas kartës së identitetit për përfituesin dhe shkaktarin e dëmit (në rastet kur shkaktari është i identifikuar), me targat e automjetit shkaktar, targat e automjetit të dëmtuar, emrin dhe mbiemrin e shkaktarit të dëmit, emrin e shoqërisë së sigurimit që ka raportuar dëmin në Byro, klasifikimin në dëm pasuror/jopasuror, shumën e paguar, shumën që kërkohet për regres shkaktarit etj., brenda datës 31.08.2017;
 - 1.4 Të unifikojë menjëherë databazën e dëmeve duke eliminuar mbajtjen e dy databazave paralele;
 - 1.5 Të realizojë blerjen dhe vënien në funksion të një programi informatik profesional për dëmet, brenda datës 31.12.2017;
 - 1.6 Të mbajë evidenca mujore për praktikën e fondit të kompensimit për ngjarjet e vitit 2017, sipas tabelës bashkëngjitur. Këto evidenca do të dorëzohen në Autoritet së bashku me raportin periodik që depoziton BSHS brenda datës 10 të çdo muaji;
 - 1.7 Të marrë masa për të mbajtur faqen zyrtare të internetit që të përmbushë në mënyrë efikase detyrimin për informim, si dhe të krijojë infrastrukturën e kësaj faqeje përsa i përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore, brenda datës 31.08.2017.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Pasqyrë e dëmeve të fondit të kompensimit për periudhën _____ sipas shoqërive (progresive gjatë vitit)

Formulari 1

[illegible]